

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 19.9.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 31.12.2020, “MBI KRITERET  
DHE PROCEDURËN PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORËVE TË TURIZMIT  
DETAR”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 43, datë 27.4.2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 4, datë 31.12.2020, “Mbi kriteret dhe procedurën për certifikimin e operatorëve të turizmit detar” bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” e pikës 2, të kreut III shfuqizohet.

2. Pika 1, e kreut IV ndryshohet si më poshtë:

*“Kërkesa me dokumentacionin, sipas kreut 3, pika 2, të këtij udhëzimi depozitohet online, nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” dhe shqyrtohet nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike.”*

3. Pika 2, e kreut IV ndryshohet si më poshtë:

*“Komisioni, brenda 10 ditëve pune nga data e aplikimit dhe ngarkimit të dokumentacionit në portalin qeveritar “e-Albania”, sipas pikës 2, të kreut III, nis shqyrtimin e kërkesës”.*

4. Pika 3, e kreut IV, ndryshohet si më poshtë:

*“Në qoftë se kërkesa e subjektit për pajisjen me certifikatë nuk është në përputhje me sa parashikohet në pikat 1 deri në 2, të kreut III, Komisioni, brenda 5 ditëve pune nga data e shqyrtimit të kërkesës, njofton aplikuesin nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania, për plotësimin e dokumentacionit ose korrigjimin e pasaktësive dhe i cakton atij një afat prej 7 ditë pune për paraqitjen e dokumentacionit përkatës.”*

5. Pika 5 e kreut IV ndryshohet si më poshtë:

*“Në përfundim të procesit të shqyrtimit, Komisioni i Standardizimit merr vendim për lëshimin ose jo të certifikatës “Operator i turizmit detar”. Vendimi i njoftohet kërkuarit nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania brenda 5 ditë pune nga data e marrjes së vendimit. Në rastet kur komisioni refuzon kërkesën për pajisje me certifikatë, vendimi dubet të jetë i arsyetuar.”*

6. Pika 3, e kreut V ndryshohet si më poshtë:

*“Për çdo ndryshim të të dhënave të operatorit të turizmit detar, subjekti është i detyruar, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, të informojë ministrinë përgjegjëse për turizmin.”*

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**Mirela Kumbaro Furxhi**

**KËRKESË PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË “OPERATOR I TURIZMIT DETAR”**

<b>SEKSIONI A</b>	
<b>Informacion mbi përfaqësuesin ligjor</b>	
Emri	
Mbiemri	
Numër personal	
Adresa	
Numër telefoni	

Adresë e-mail	
<b>Informacion mbi subjektin</b>	
Emri tregtar	
NIPT	
Numër licence	
Adresa	
Numër telefoni	
Adresë email	
<b>SEKSIONI B</b>	
Zona e ushtrimit të aktivitetit	
Përshkrimi i aktivitetit / aktiviteteve të parashikuara	

### **SEKSIONI C:**

#### **Dokumentacion shoqërues:**

- a) fotokopje të licensës XIII.1.B dhe një kopje e ekstraktit historik të QKR;
- b) kontratën e vendbazimit (lidhur mes subjektit aplikues dhe subjektit që administron vendbazimin;
- c) plani i menaxhimit të emergjencave (nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit);
- d) dokumenti që vërteton pronësinë apo kontratën noteriale (lidhur për përdorimin e mjeteve lundruese me qëllim aktivitetin detar);
- e) lista me të dhënat e mjeteve të lundrimit (në funksion të aktiviteteve që do të ofrohen):
  - lloji i mjetit;
  - numri i identifikimit;
  - flamuri (për mjetet me flamuj të huaj, një kopje të licencës VII.4.1);
  - kapaciteti;
  - viti i prodhimit;
  - personi përgjegjës;
  - numri i kontaktit;
- f) certifikata e sigurisë apo klasës së lëshuar nga shoqëria klasifikuese (sipas legjislacionit në fuqi për mjetet lundruese);
- g) policë sigurimi e mjetit lundrues, të përgjegjësishë ndaj palëve të tretat;
- h) deklarata e nënshkruar (nga subjekti) ku angazhohet të respektojë kriteret e përcaktuara në Kodin e Etikës së Operatorit të Turizmit Detar.